



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Nr.270/25, Datë: 20.03.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 135 të mbajtur më 10.03.2025, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet Rregullorja (AKA) Nr. **01/2025** për Procedurat dhe Kriteret për Vlerësim të Jashtëm nga Agjencia Ndërkombëtare e Akreditimit.

- II. Ky dokument hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Bazuar në dispozitat ligjore të cekuar më lart Agjencia e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) ka zbatuar në procedurat ligjore për hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore duke përfshirë konsultimet paraprake dhe konsultimet publike. Në zbatim të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, kompetencat ligjore dhe duke ju referuar procesverbalit të mbledhjes së 135-të, mbajtur me datë 10.03.2025, Këshilli Shtetëror i Cilësisë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Publikohet në ueb faqe të AKA-së;
- Arkivit të AKA



Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



**RREGULLORE (AKA) Nr.01/2025 PËR
PROCEDURAT DHE KRITERET PËR
VLERËSIM TË JASHTËM NGA AGJENCITË
NDËRKOMBËTARE TË AKREDITIMIT**

Në mbështetje të nenit 39, nenit 40, paragrafi 1, nënparagrafi 1.9. dhe paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-110 për Agjencinë Kosovare të Akreditimit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 13, 29 qershor 2023), Këshilli Shtetëror i Cilësisë (në tekstin e mëtejshëm: KShC) në mledhjen e 135-të të datës 10.03.2025, miratoi këtë:

RREGULLORE (AKA) Nr.01/2025 PËR PROCEDURAT DHE KRITERET PËR VLERËSIM TË JASHTËM NGA AGJENCITË NDËRKOMBËTARE TË AKREDITIMIT

Neni 1

Qëllimet e Rregullores

Kjo rregullore synon të përcaktojë procedurën dhe kriteret e AKA-së për vlerësimin e jashtëm të Institucioneve apo programeve të Arsimit të Lartë nga agjencitë ndërkombëtare të akreditimit.

Neni 2

Fushëveprimi i Rregullores

1. Fushëveprimi i Rregullores përfshin procedurën dhe kriteret e vlerësimit në rast se:
 - 1.1. një institucion i arsimit të lartë kërkon vlerësim të jashtëm në nivel institucional dhe/ose në nivel të programeve të studimit nga një agjenci ndërkombëtare akreditimi
 - 1.2. një institucion i arsimit të lartë i akredituar nga AKA në bashkëpunim me një universitet partner ndërkombëtar vendos të sjellë në Kosovë programe studimi të cilat në vendin e tyre të origjinës janë të akredituara nga agjencia ndërkombëtare e akreditimit.

Neni 3

Përkufizime

1. Për qëllime të këtij dokumenti, shkurtesat e përdorura kanë kuptimet si në vijim:
 - 1.1. **AKA** - “Agjencia Kosovare e Akreditimit”;
 - 1.2. **IAL** - “Institucion i Arsimit të Lartë”;
 - 1.3. **KShC** - “Këshilli Shtetëror i Cilësisë”;
 - 1.4. **Ministria** -Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë në Kosovë;
 - 1.5. **RESC** - “Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë”;
 - 1.6. **DShA** - “Departamenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Arsim”;
 - 1.7. **KAAL** - “Këshilli për Akreditimin e Arsimit të Lartë”;
 - 1.8. **SUE** - “Standardet dhe udhëzimet evropiane për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë”.
2. Nëse eventualisht shkurtesat nuk janë të qarta, zbatohen përkufizimet e përcaktuara sipas ligjit për AKA-në.

Neni 4

Parimet Bazë

1. Kjo Rregullore është krijuar mbi parimet thelbësore të Standardeve dhe Udhëzimeve Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë të cilat janë:
 - 1.1. Institucionet e arsimit të lartë kanë përgjegjësinë kryesore për cilësinë e ofrimit të tyre dhe sigurimin e tyre;
 - 1.2. Sigurimi i cilësisë i përgjigjet diversitetit të sistemeve të arsimit të lartë, institucioneve, programeve dhe studentëve;
 - 1.3. Sigurimi i cilësisë mbështet zhvillimin e një kulture të cilësisë;
 - 1.4. Sigurimi i cilësisë merr parasysh nevojat dhe pritjet e studentëve, të gjithë palëve të interesuara të tjerë dhe shoqërisë.
2. Së dyti, manuali aktual bazohet mbi parimet e mëposhtme:
 - 2.1. Llogaridhënia publike: Institucionet e arsimit të lartë duhet të demonstrojnë cilësinë e arsimit për të gjitha palët e interesuara dhe publikun e gjerë, nëpërmjet:
 - 2.2. arritjes së niveleve të cilësisë që i përgjigjen pritjeve të studentëve dhe punëdhënësve;
 - 2.3. nënvizimit të arsimit të lartë si një të mirë publike;
 - 2.4. komunikimit të informacionit të qëndrueshëm, të qartë dhe koherent për publikun në përgjithësi rreth rezultateve reale të arritura dhe synimeve të përmirësimit.

3. Referenca Evropiane: sistemi i arsimit të lartë dhe institucionet në Kosovë i përkasin Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë dhe sigurojnë nivele të cilësisë në përputhje me, dhe konkurruese në nivel evropian dhe ndërkombëtar. Për këtë qëllim, si ofruesit e njohur të akreditimit, ashtu edhe institucionet e arsimit të lartë angazhohen për të krahasuar proceset e tyre institucionale me institucione të krahasueshme në nivel ndërkombëtar;
4. Përgjegjësia institucionale: përgjegjësia për cilësinë dhe menaxhimin e cilësisë i takon çdo IAL, në përputhje me autonominë institucionale;
5. Përmirësimi i cilësisë: cilësia nuk është një qëllim në vetvete. Përmirësimi i vazhdueshëm dhe menaxhimi institucional i cilësisë është objektivi kryesor i vlerësimeve të jashtme;
6. Përshtatshmëria për qëllimin: procesi i sigurimit të cilësisë duhet të përcaktohet dhe të projektohet në mënyrë specifike për të siguruar përshtatshmërinë e tyre për të arritur qëllimet dhe objektivat e përcaktuara për to;
7. Diversiteti institucional: diversiteti i institucioneve, misioni dhe qëllimet e tyre respektohen dhe inkurajohen nga sigurimi i jashtëm i cilësisë;
8. Transparenca: një koncept kyç që ndihmon në ndërtimin e besimit të ndërsjellë dhe njohjen më të mirë të kualifikimeve, programeve dhe ofrimin e shërbimeve të tjera. Në nivelin sistematik, transparenca jo vetëm që rrit besimin në operacionet e strukturave të sigurimit të cilësisë, por edhe në vetë arsimin. Institucionalisht, transparenca inkurajon angazhimin e të gjithë komunitetit akademik dhe zhvillimin e kulturës së cilësisë.
9. Fokusimi në rezultate: rezultatet e të mësuarit dhe performanca në hulumtim qëndrojnë në thelbin e sigurimit të cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë nënkupton që institucionet e arsimit të lartë demonstronë rezultatet dhe performancën e tyre në mësim dhe hulumtim, si dhe korrespondencën e tyre me realitetin aktual të institucionit, duke përfshirë verifikimin e aktivitetit të studentëve në lidhje me standardet e deklaruara;
10. Angazhimi i palëve të interesuara: palët e brendshme të interesuara duhet të zhvillojnë dhe zbatojnë politikat e sigurimit të cilësisë përmes strukturave dhe proceseve të përshtatshme, duke përfshirë palët e jashtme;
11. Përmirësimi i cilësisë: përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë dhe menaxhimi institucional është objektivi kryesor i vlerësimit të jashtëm. Çdo dokument i vetëvlerësimit duhet të paraqesë veçoritë e kulturës së cilësisë në të gjithë institucionet e arsimit të lartë dhe të sigurojë përmirësimin e vazhdueshëm të performancës.
12. Etika dhe integriteti - AKA siguron që të gjitha proceset e vlerësimit dhe kontrollit të cilësisë, të cilat çojnë në një rezultat formal, të jenë procese të besueshme dhe profesionale të bazuara në vlerë.

13. Objektiviteti dhe paanshmëria: Proceset e akreditimit të IAL-ve duhet të kryhen me objektivitet dhe paanshmëri, pa paragjykime, ndikime të padrejta ose konflikte interesi. Vendimet duhet të bazohen në prova, të dhëna dhe kritere të njohura.
14. Efikasiteti dhe efektiviteti: Janë parime themelore të standardeve të akreditimit për institucionet e arsimit të lartë pasi ato promovojnë sigurimin e cilësisë, përmirësimin e vazhdueshëm, suksesin e studentëve, përgjegjshmërinë, transparencën dhe konkurrencën globale.
15. Këto parime ofrojnë një kornizë referuese për veprimtarinë e AKA-së dhe manualin aktual. Qëllimi i tyre është të promovojnë një kulturë cilësore që kontribuon vazhdimisht në arritjen e një sistemi cilësor të arsimit të lartë.

Neni 5

Aplikimi për vlerësim të akreditimit ndërkombëtar

1. KShC-ja i trajton dhe vendos për aplikimet për vlerësimin e akreditimit ndërkombëtar të institucioneve të arsimit të lartë që funksionojnë në territorin e Republikës së Kosovës dhe diplomat e tyre i nënshtrohen vlerësimit nga ministria përkatëse e arsimit.
2. Aplikimi për vlerësimin e akreditimit ndërkombëtar kërkohet në rastet në vijim:
 - 2.1 nëse një institucion i arsimit të lartë kërkon vlerësim të jashtëm në nivelin institucional dhe/ose në nivel të programeve të studimit nga një agjenci ndërkombëtare e akreditimit;
 - 2.2 nëse një institucion i akredituar nga AKA-ja, në bashkëpunim me një universitet partner ndërkombëtar, vendos të sjellë në Kosovë programe studimi të cilat në vendin e tyre të origjinës janë akredituar nga Agjencia përkatëse e Akreditimit.
3. Në të dyja rastet, procedura e vlerësimit fillon vetëm nëse agjencitë përkatëse ndërkombëtare të akreditimit janë të listuara në Regjistrin Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë (RESC) ose të njohura nga Departamenti i Shtetit për Arsim (DShA) ose Këshilli për Akreditimin e Arsimit të Lartë (KAAL).
4. IAL-ja që paraqet kërkesë për vlerësim do t'i nënshtrohet një kontrolli paraprak nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC), për të garantuar plotësimin e kritereve minimale të përcaktuara nga legjislacioni dhe rregulloret e vlerësimit.
5. Afatet kohore dhe procedurat e aplikimit janë përcaktuar me nenin 30 të Ligjit për Agjencinë e Akreditimit.

Neni 6

Procedura dhe kriteret e vlerësimit të akreditimit

1. Kur një institucion i arsimit të lartë kërkon vlerësim të jashtëm në nivel institucional dhe/ose të programit studimor nga një agjenci ndërkombëtare e akreditimit, duhet të zbatohet procedura dhe kriteret e mëposhtme:
 - 1.1 Institucioni i arsimit të lartë duhet të paraqesë termat e referencës të rëna dakord me agjencinë e zgjedhur ndërkombëtare të akreditimit.
 - 1.2 Termat e referencës duhet të hartohen dhe të përcaktohen nga IAL-ja dhe agjencia ndërkombëtare e akreditimit dhe të përpilohen në përputhje të plotë me këtë rregullore, standardet dhe udhëzimet evropiane për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë (SUE) dhe standardet e akreditimit të SHBA-së.
 - 1.3 Është e obligueshme që termat e referencës të reflektojnë po ashtu:
 - 1.3.1. transparencën e procedurës së vlerësimit;
 - 1.3.2. pavarësinë e panelit të ekspertëve në lidhje me IAL-në nën vlerësim;
 - 1.3.3. përzgjedhjen dhe përvojën e ekspertëve;
 - 1.3.4. të drejtat dhe obligimet kontraktuale të përcaktuara nga IAL-ja dhe agjencia ndërkombëtare e akreditimit.
 - 1.3.5. dispozitat rreth procedurës së ankesave në përputhje me standardin 2.7 të SUE-së.
 - 1.3.6. dispozitat lidhur me përmbushjen e nenit 9, paragrafi 3 dhe 4 dhe nenit 12 të Rregullores së AKA-së Nr. 04/2024.
 - 1.3.7. zotimin e agjencisë ndërkombëtare të akreditimit për t'i zbatuar procedurat përcjellëse nëse një gjë e tillë kërkohet nga AKA-ja.
 - 1.4. Metodologjia e vlerësimit të jashtëm nga një agjenci ndërkombëtare akreditimi duhet të përfshijë kriteret, standarde dhe tregues që i plotësojnë ato kombëtare, por ato në asnjë rast nuk duhet të jenë në kundërshtim me legjislacionin e Kosovës dhe rregulloren Nr. 04/2024.
 - 1.5. Agjencia ndërkombëtare e akreditimit duhet ta caktojë së paku një ekspert i cili është i njohur me sistemin e arsimit të lartë dhe shkencës në Kosovë si dhe me procedurat e AKA-së për sigurimin e jashtëm të cilësisë.
 - 1.6. KShC-ja duhet ta analizojë metodologjinë dhe termat e referencës dhe vetëm nëse KShC-ja e miraton atë, IAL-ja ka të drejtë të vazhdojë me vlerësimin e jashtëm me agjencinë ndërkombëtare të akreditimit.
 - 1.7. Pas miratimit, AKA-ja duhet të publikojë në faqen e saj të internetit termat e referencës dhe metodologjinë e vlerësimit të jashtëm.
 - 1.8. Përfaqësuesi i stafit të AKA-së merr pjesë në vizitën në terren si vëzhgues dhe në atë rast duhet ta nënshkruajë një *Deklaratë Konfidencialiteti*.

- 1.9. Agjencia ndërkombëtare e akreditimit duhet ta informojë AKA-në për të gjithë procedurën (p.sh. hartimin e raportit, marrjen e komenteve dhe raportin përfundimtar).
- 1.10. Raporti përfundimtar i ekspertit të jashtëm duhet të përfshijë rekomandimin në lidhje me vlerësimin e institucionit dhe/ose të programit të studimeve, kohëzgjatjen e periudhës së akreditimit sipas legjislacionit të Kosovës, si dhe numrin maksimal të studentëve që mund të regjistrohen në atë program të studimeve të caktuar për vit akademik, në rast se vendimi për akreditim është poziti.
- 1.11. Raporti përfundimtar dhe vendimi i akreditimit duhet t'i dorëzohen KShC-së.
- 1.12. Vendimi i akreditimit nga agjencia ndërkombëtare e akreditimit duhet të përfshijë:
 - 1.12.1. Rekomandimin përfundimtar;
 - 1.12.2. Kohëzgjatjen e akreditimit në përputhje me Ligjin për AKA-në;
 - 1.12.3. Numrin e studentëve për vit akademik.
- 1.13. Vendimi i KShC-së për vlerësim është përfundimtar dhe pala e pakënaqur me vendimin përfundimtar të KShC-së mund të paraqesë ankesë në Komisionin e Ankesave të AKA-së sipas dispozitave të Ligjit për AKA-në.
- 1.14. AKA-ja duhet të publikojë në faqen e saj të internetit raportin e vlerësimit dhe vendimin për vlerësimin.
- 1.15. Institucionet/programet e vlerësuara u nënshtrohen procedurave të monitorimit të përcaktuara me legjislacionin e Kosovës dhe rregulloret e AKA-së.
2. Në rast se një institucion i akredituar nga AKA-ja në bashkëpunim me një universitet partner ndërkombëtar vendos të sjellë në Kosovë programe studimi të cilat në vendin e tyre të origjinës janë akredituar nga agjencia ndërkombëtare e akreditimit, programi duhet t'i nënshtrohet procedurave të akreditimit ose vlerësimit bazuar në rregulloret e AKA-së.

Neni 7

Dispozitat përfundimtare

Kjo Rregullore për Procedurat dhe Kriteret për Vlerësim të Jashtëm nga Agjencia Ndërkombëtare e Akreditimit duhet të hyjë në fuqi me rastin e miratimit të saj nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë. Kjo Rregullore për Procedurat dhe Kriteret për Vlerësimin e Jashtëm nga Agjencia Ndërkombëtare e Akreditimit duhet të publikohet në faqen zyrtare të AKA-së pas nënshkrimit të të vendimit për aprovimin e saj nga Kryetari/ja e/i KShC-së.

Prishtinë, 20.03.2025

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë